



Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjëlber

DORACAK I GRANTIT

**Rregullat dhe procedurat për zbatimin e skemës së
nën-granteve si pjesë e projektit**

**“Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore në
Korab-Koritnik, Malin Sharr dhe Alpet Shqiptare”**

I MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA PONT

IMPLEMENTUAR NGA CNVP

Nëntor 2024



Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjëlber

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Rajoni i projektit.....	3
3. Objektivat.....	5
4. Grupet e synuara.....	5
5. Procedurat:.....	5
6. Fazat e nën-grantimit.....	5
7. Ndarja e buxhetit.....	6
8. Aplikantët e kualifikuar për nën-grantim.....	7
9. Aktivitetet e papranueshme.....	9
10. Dorëzimi i propozimeve.....	11
11. Kriteret e vlerësimit.....	11
12. Shpenzimet e pranueshme.....	12
13. Kontraktimi.....	13
14. Raportimi dhe Monitorimi.....	13



Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër


1. Hyrje

Ky doracak i përshkruan udhëzimet dhe procedurat për skemat e nën-granteve për Përdorimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore për Bashkëpunim Ndërkufitar Socio-Ekonomik në Zonat e Mbrojtura në Maqedoninë e Veriut, i zbatuar nga Fondacioni për Bashkimin e Vlerave të Natyrës me Njerëzit (CNVP) me zyrë në Maqedoninë e Veriut. Projekti financohet nga Fondi i Natyrës “Prespa-Ohri” (PONT)

2. Rajoni i projektit

Skema e nën-granteve në kuadër të projektit “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Zhvillimin Ndërkufitar Socio-Ekonomik të Zonave të Mbrojtura në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri (Korab-Koritnik, Malin Sharr dhe Alpet Shqiptare)” do të mbështesë veprimet në zonën e projektit që përfshin rajonin e Parkut Kombëtar të Malit Sharr dhe Parkut Kombëtar të Mavrovës. Tabela e mëposhtme tregon vizualisht veprimet që do të ndërmerren në këto zona të mbrojtura.

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër





Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

3. Objektivat

Objektivi kryesor i këtij projekti është promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore duke ofruar dhe mbështetur komunitetet lokale për të krijuar një jetë më të mirë socio-ekonomike në harmoni me natyrën. Objektivat specifike të projektit përfshijnë:

- Përdorimi i qëndrueshëm të produkteve pyjore jodrunore në zonat e mbrojtura të Malit Sharr, Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare kontribuon në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e komuniteteve lokale.
- Turizmi i bazuar në natyrë në zonat e mbrojtura të Malit Sharr, Korab-Koritnikut dhe Alpeve Shqiptare kontribuon në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e komuniteteve lokale në këto zona të mbrojtura.
- Mekanizmat për menaxhimin e Malit Sharr, Korab-Koritnikut dhe Alpeve Shqiptare që mundësojnë zhvillimin e turizmit të bazuar në natyrë dhe mënyra të tjera të përdorimit të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura.

4. Grupet e synuara

Nën-grantet do t'u jepen organizatave joqeveritare lokale (OJQ-ve), ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (**me qëllim të “gjellbërimit” ose përmirësimit të qëndrueshmërisë ekologjike të biznesit të tyre**), komunave, fermerëve individualë të regjistruar dhe komuniteteve lokale, në territorin e Parkut Kombëtar të Mavrovës dhe Parkut Kombëtar të Malit Sharr në Maqedoninë e Veriut, konkretisht në komunat Tearcë, Jegunovcë, Tetovë, Bogovinë, Vrapçisht, Gostivar dhe Mavrovë-Rostushë.

5. Procedurat:

Skema e nën-granteve do të realizohet përmes thirrjes së hapur. Thirrja e parë e hapur për skemën e nën-granteve do të shpallet gjatë 28 Nëntor deri me 10 Janar 2025. Thirrja do të pranojë aplikime nga grupet e synuara që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve dhe të aktiviteteve turistike të bazuara në natyrë.

6. Fazat e nën-grantimit

- **Publikimi i mundësisë për grante:** Reklamimi i mundësisë për grante përmes mediave lokale, mediave sociale dhe ueb-faqes zyrtare të CNVP-së, ueb-faqeve zyrtare të komunave të përfshira nga projekti. Dërgimi i e-mailit direkt tek përdoruesit e mundshëm që janë identifikuar në terren, dhe kanalet e tjera përkatëse për t'i kontaktuar përfituesit e mundshëm.
- Sesion informativ më date 17 Dhjetor 2024, do të mbahen në zonën e projektit, duke i informuar në detaje aplikantët e interesuar lidhur me thirrjen.

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

- **Pranimi dhe shqyrtimi i aplikimeve:** Pranimi dhe shqyrtimi i aplikimeve nga përfituesit e interesuar. Aplikimet duhet të përfshijnë detaje në lidhje me projektin, objektivat e tij, rezultatet e pritura, buxhetin dhe planin e zbatimit. Një komision i pavarur shqyrtues do t'i zgjedhë propozimet më të mira të projekteve që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkruara më poshtë, duke u bazuar në lidhshmërinë e tyre me objektivat, fizibilitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e projektit (Shih Shtojcën 1, Shtojcën 2).
- **Lista e ngushtë e aplikantëve:** Lista e ngushtë e aplikantëve në bazë të pranueshmërisë së tyre dhe cilësisë së propozimeve të tyre.
- **Kontraktimi i përfituesve.** – kontratat ligjore do të nënshkruhen së bashku me një plan monitorimi.
- **Lëshimi i fondeve:** Lëshimi i fondeve për nën-grantistët sipas planit të lëshimit të kësteve dhe dispozitave të përcaktuara në marrëveshje.
- **Monitorimi i progresit:** Monitorimi i progresit të projekteve përmes vizitave të rregullta në terren dhe raporteve të progresit nga nën-grantistët.
- **Vlerësimi i rezultateve:** Vlerësimi i rezultateve të projekteve për të përcaktuar ndikimin e tyre real në përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve dhe aktivitetet turistike të bazuara në natyrë, dhe identifikimi i mësimëve të nxjerra për mundësitë për grante në të ardhmen.
- **Ndarja e historive të suksesit:** Ndarja e historive të suksesit nga projektet për të frymëzuar dhe motivuar të tjerët që të angazhohen në përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve dhe aktivitetet turistike të bazuara në natyrë.

7. Ndarja e buxhetit

Për shkak të nevojave dhe kufizimeve të ndryshme të grupit të synuar, programi do të ofrojë lloje të ndryshme grantesh në përputhje me aplikimet e pranuar.

Përfituesit inkurajohen të bashkë-financojnë propozimin/aplikimin me 20% të buxhetit total. Ky bashkë-financim nuk është i detyrueshëm. Pranohet edhe kontributi në natyrë. Kontributi në natyrë mund të vlerësohet financiarisht duke e vlerësuar vlerën monetare të mallrave ose shërbimeve që ofrohen si kontribut. Kjo mund të bëhet duke e krahasuar koston e mallrave ose shërbimeve në treg me vlerën e kontributit.

Kontributi në natyrë i përfituesve mund të jetë si më poshtë:

- Kohë vullnetare: përfituesit mund të ofrojnë kohë vullnetare si bashkë-financim në natyrë, ku stafi ose anëtarët e tyre ofrojnë kohën dhe ekspertizën e tyre vullnetare për të mbështetur projektin.
- Hapësira për zyra: përfituesit mund të ofrojnë hapësirë për zyra si bashkë-financim në natyrë, ku ata lejojnë ekipin e projektit të përdorë hapësirën e tyre të zyrës pa pagesë.

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

- Pajisje dhe materiale: përfituesit mund të ofrojnë pajisje dhe materiale si bashkë-financim në natyrë, ku ata ofrojnë pajisjet dhe materialet e nevojshme për projektin, si kompjuterë, printerë dhe materiale zyre.
- Ekspertizë: përfituesit mund të ofrojnë ekspertizën e tyre si bashkë-financim në natyrë, ku ata ofrojnë asistencë teknike ose shërbime këshillimi për projektin.
- Trajtime: përfituesit mund të ofrojnë trajtime si bashkë-financim në natyrë, ku ata ofrojnë trajtime për ekipin e projektit ose përfituesit e projektit.
- Fuqi punëtore: p.sh. përfituesit mund të ofrojnë fuqi punëtore si bashkë-financim në natyrë, ku anëtarët e grupit kontribuojnë me kohën dhe përpjekjet e tyre për të mbështetur projektin.
- Tokë: përfituesit mund të ofrojnë tokë si bashkë-financim në natyrë, ku ata lejojnë ekipin e projektit të përdorë tokën e tyre për projektin, si p.sh. për mbjelljen e kulturave bujqësore ose ndërtimin e infrastrukturës.
- Pajisje dhe makineri: përfituesit mund të ofrojnë pajisje dhe makineri si bashkë-financim në natyrë, ku ata ofrojnë pajisjet dhe makineritë e nevojshme për projektin, si p.sh. traktorët ose sistemet e ujitjes.
- Materiale: përfituesit mund të ofrojnë materiale si bashkë-financim në natyrë, ku ata ofrojnë fara, plehra ose materiale të tjera të nevojshme për projektin.
- Marketingu dhe shpërndarja: përfituesit mund të ofrojnë shërbime marketingu dhe shpërndarjeje si bashkë-financim në natyrë, ku ata ndihmojnë në tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve të projektit te konsumatorët.

8. Aplikantët e kualifikuar për nën-grantim

OJQ-të e regjistruara si organizatë jofitimprurëse, në bazë të Ligjit për Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet të R. të Maqedonisë së Veriut, në territorin e komunave të Tearcës, Jegunovcës, Tetovës, Bogovinës, Vrapçishtit, Gostivarit dhe Mavrovë-Rostushës dhe të jenë aktive së paku 12 muaj para datës së publikimit të thirrjes.

E rëndësishme:

- **Aplikantët që kanë të përfshirë persona të punësuar në zonat e mbrojtura të Parkut Kombëtar Mali Sharr dhe Parkut Kombëtar të Mavrovës (anëtarë të këshillave drejtuese, personel administrativ dhe personel teknik) dhe njëkohësisht janë anëtarë të organeve administrative dhe drejtuese ose veprojnë si staf/ekspertë në personin juridik që aplikon nuk kanë të drejtë të aplikojnë në thirrje.**
- **Aplikantët që janë aktualisht përfitues të drejtpërdrejtë të PONT, nuk kanë të drejtë të aplikojnë.**
 - **Përfshirë nga ky rregull bëjnë aplikantët, projektet e të cilëve të financuara nga PONT përfundojnë përpara skadimit të afatit të thirrjes aktuale për aplikime.**

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

Skema e nën-granteve mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për organizatat lokale për përmirësimin e kapaciteteve teknike (punëtori, vizita studimore ndërkufitare) duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor, nga perspektiva e TBN, PPJD dhe biodiversitetit.
- Ngritja e vetëdijes dhe trajnimet e komuniteteve lokale për grumbullimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve në zonat e mbrojtura (praktikat dhe rregulloret e mbledhjes së qëndrueshme, mjetet alternative të jetesës, ruajtja, efektet ndërkufitare dhe bashkëpunimi me autoritetet)
- Përmirësimi i mekanizmave për përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve (aftësitë sipërmarrëse, promovimi, zhvillimi i produkteve pyjore jodrunore, bimëve mjekësore dhe aromatike, dhe turizmit të bazuar në natyrë).
- Prokurimi i pajisjeve për përmirësimin e objekteve për përpunimin dhe tharjen e produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike (Llojet e pajisjeve: pranimit, mbledhja dhe ruajtja, përgatitja për klasifikim, pastrimi, larja, tharja, dezinfektimi, klasifikimi, kalibrimi, heqja e frutave të dëmtuara, pajisjet për prerje, bluarje dhe pajisje të tjera për përgatitje para përpunimit, pajisje për konservim, tharje, ngrirje, pajisje mbushëse, futja në shishe, ambalazhimi dhe shënimi/etiketimi, pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme kontrolli me mundësi për gjurmimin e pranimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produktit).
- Certifikimi për mbledhësit organikë.
- Përmirësimi i kapaciteteve për kultivimin organik të produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave. (Ofrimi i trajnimeve, burimeve dhe mbështetjes për komunitetet lokale për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë praktika kultivimi të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin jetësor, për të krijuar lidhje tregu, dhe për të promovuar praktika të qëndrueshme).
- Krijimi i konsoliduesve lokalë për BMA-të dhe produktet e tjera pyjore jodrunore për të garantuar tregti të drejtë dhe praktika të qëndrueshme të mbledhjes (partneritetet me komunitetet lokale, promovimi i praktikave të qëndrueshme të mbledhjes, ofrimi i trajnimeve dhe burimeve dhe sigurimi i çmimeve të drejta).
- Prokurimi i pajisjeve për përpunimin dhe prodhimin e ushqimit tradicional nga ofruesit e shërbimeve turistike të bazuara në natyrë (pajisje për përpunim: prerës, bluarës dhe dehidratues, pajisje për prodhim: furra, soba dhe enë, pajisje për turizmin e bazuar në natyrë, si p.sh. pajisje për bjeshkatori dhe kamping, pajisje për turizëm aventurier, pajisje për sporte ujore, vëzhgim të kafshëve të egra etj.).
- Promovimi i tureve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonominë lokale dhe për të ruajtur traditat kulturore. Mund të mbështeten edhe aktivitetet ndërkufitare për promovim.
- Rregullimi/përmirësimi i kapaciteteve dhe objekteve akomoduese private pranë ofruesve të shërbimeve turistike/produkteve të bazuara në natyrë (për rregullimin, pajisjen apo rinovimin e objektit sipas traditës në vend).

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të bazuara në natyrë në zonat e mbrojtura .

Kjo listë nuk është e kufizuar. Aktivitete të tjera të pranueshme dhe të përshtatshme mund të përcaktohen dhe shtohen në thirrjet e ardhshme.

9. Aktivitetet e papranueshme

Artikulli:	Kontrolluar
Çdo operacion që çon në ose kërkon shkatërrimin ^[1] e habitatit kritik ^[2] ose ndonjë program pyjor i cili nuk zbaton një plan për përmirësim dhe menaxhim të qëndrueshëm.	
Çdo aktivitet që mund të shoqërohet me dëmtim të konsiderueshëm të zonave veçanërisht të denja për mbrojtje (pa kompensim adekuat në përputhje me standardet ndërkombëtare).	
Tregtia e kafshëve, bimëve ose cilado produkteve natyrore që nuk përputhet me dispozitat e Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve (Specieve) të Rrezikuara (CITES)/ Konventa e Uashingtonit ^[3] .	
Metodat shkatërruese të peshkimit	
Operacionet e prerjes komerciale të drurit për përdorim në pyjet parësore.	
Prodhimi ose tregtimi i drurit ose produkteve të tjera pyjore, të ndryshme nga pyjet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme.	
Ndryshime në shkallë të gjerë dhe domethënëse në përdorimin e burimeve natyrore (p.sh. disa përdorime të tjera të tokës: si tokë bujqësore, tokë drunore ose kullotë, për zhvillim rural, për lëndë drurore komerciale etj.) si dhe bonifikimi i tokës në shkallë të gjerë.	
Ndryshime në shkallë të gjerë dhe domethënëse në metodat e kultivimit në bujqësi dhe peshkim (p.sh. futja e bimëve të reja, mekanizimi në shkallë të gjerë, futja e llojeve të reja të peshkut) si dhe prerjet e drurit në shkallë të madhe.	
Përdorimi i burimeve ujore (p.sh. diga të mëdha dhe struktura të tjera mbajtëse të ujit, objektet e depozitimit të pompave ose termocentralet, projektet e ujitjes dhe kullimit, puse të thella, menaxhimi i ujit dhe menaxhimi dhe zhvillimi i pellgjeve ujëmbledhëse, furnizimi me ujë, impiantet e shkripëzimit të ujit të detit).	
Infrastruktura (p.sh. rrugët, urat, aeroportet, portet, linjat e transmetimit, tubacionet, rrjetet hekurudhore, transporti tjetër hekurudhor, turizmi).	

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjelbër

Prodhimi i energjisë (p.sh. parqe të mëdha të erës dhe diellore, sistemet e biomasës, objektet gjeotermale, termocentralet).	
Aktivitetet industriale (p.sh. shkretoret e metaleve, objektet e përpunimit të lëndës drunore, fabrikat kimike, fabrikat e çimentos, rafineritë dhe fabrikat petrokimike, industritë bujqësore).	
Përdorimi i burimeve gjeologjike, xehetaria dhe të tjera (p.sh. miniera dhe gurore).	
Menaxhimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe ujërave të zeza (p.sh. sistemet dhe impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, vendet e deponive, impiantet e ripërpunimit të mbetjeve shtëpiake dhe mbetjeve të rrezikshme).	
Aktivitete që përfshijnë forma të dëmshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar ^[4] ose punë të dëmshme për fëmijët ^[5] .	
Programe që përfshijnë zhvendosje fizike të pavullnetshme dhe/ose dëbim të detyruar.	
Prodhim ose aktivitete që cenojnë tokat që janë në pronësi, ose që pretendohen në bazë të vendimit gjyqësor, nga popujt indigjenë, pa pëlqimin e plotë të dokumentuar të këtyre popujve.	
Prodhimi, përdorimi, shitja ose tregtimi i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve, substancave që shkatërrojnë shtresën e ozonit ^[6] dhe materiale të tjera toksike ^[7] ose të rrezikshme si azbesti ose produkte që përmbajnë PCB ^[8] , kafshë të egra ose produkte të rregulluara sipas CITES, duke përfshirë të gjitha produktet që janë të ndaluara ose janë duke u hequr nga përdorimi gradualisht ndërkombëtarisht.	
Prodhimi ose tregtimi i armëve, municionit, armatimit, armëve të diskutueshme ose përbërësve të tyre (p.sh. armët bërthamore dhe municionet radioaktive, armët biologjike dhe kimike të shkatërrimit në masë, bomba thërrmuese, minat kundër personelit, uraniumi i pasuruar).	
Prokurimi i armëve të zjarrit.	
Sigurimi i financave për institucionet ushtarake të përfshira në aktivitete të ruajtjes ose sigurisë.	
Prodhimi ose tregtimi i alkoolit të fortë të destinuar për konsum njerëzor ose i pijeve të tjera alkoolike (me përjashtim të birrës dhe verës).	
Prodhimi ose tregtimi i duhanit.	

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

Lojërat e fatit, objektet e lojërave, kazinotë ose çdo shoqëri dhe ndërmarrje ekuivalente ^[9] .	
Çdo tregti që lidhet me pornografinë ose prostitucionin.	
Prodhimi ose tregtimi i materialeve radioaktive. Kjo nuk vlen për prokurimin e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë ose aplikacioneve të tjera për të cilat burimi radioaktiv është i parëndësishëm dhe/ose i mbrojtur në mënyrë adekuate.	
Prodhimi ose tregtia e asbestit të palidhur. Kjo nuk zbatohet për blerjen ose përdorimin e mbështjelljeve të çimentos me asbest të lidhur dhe me përmbajtje asbesti më pak se 20%.	
Prodhimi, tregtimi, magazinimi ose transporti i vëllimeve të konsiderueshme të kimikateve të rrezikshme, ose përdorimi për qëllime komerciale i kimikateve të rrezikshme. Kimikatet e rrezikshme përfshijnë benzinën, kerozinën dhe produkte të tjera të naftës.	
Tregtia ndërkufitare e mbetjeve, përveç atyre të pranuar nga Konventa e Bazelit dhe rregulloret e saj përbërëse ^[10] .	
Çdo aktivitet që çon në një modifikim të pakthyeshëm ose zhvendosje të konsiderueshme të një elementi të trashëgimisë kulturore kritike ^[11] .	
Prodhimi dhe shpërndarja ose investimi në media që janë raciste, antidemokratike ose që mbrojnë diskriminimin ndaj një pjese të popullsisë.	

10. Dorëzimi i propozimeve

Përmes thirrjes së hapur, aplikanti do të dorëzojë propozimet në mënyrë elektronike (përmes e-mailit në adresën cnvpmkd@cnvp-eu.org) në zyrën e CNVP-së në Shkup, Maqedonia e Veriut. Propozimet duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar në thirrjen e hapur. Propozimet e marra pas afatit nuk do të merren parasysh.

11. Kriteret e vlerësimit

Procedura për vlerësimin e aplikimeve përbëhet nga dy faza, kontrolli administrativ dhe vlerësimi i aplikimeve. Vetëm aplikimet që e kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit.

- Gjatë kontrollit administrativ kontrollohet plotësimi i kushteve të mëposhtme:
- Afati i aplikimit të pranuar;
- Plotësia e aplikimit;

Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

- Plotësimi i saktë i aplikimit;
- Nëse janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë;

Nëse aplikimi nuk i plotëson këto kushte, ai do të refuzohet dhe aplikanti do të njoftohet për këtë.

CNVP-ja do të vlerësojë propozimet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

Rëndësia e projektit: 25 pikë	a: Harmonizimi minimal me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (0-5 pikë)
	b: Harmonizimi i pjesshëm me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (6-15 pikë)
	c: Harmonizimi i fortë me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (16-25 pikë)
Buxheti: 25 pikë	a: Buxheti i paarsyeshëm ose i pamjaftueshëm (0-6 pikë)
	b: Buxheti pjesërisht i arsyeshëm dhe i realizueshëm (7-17 pikë)
	c: Buxheti i planifikuar mirë dhe realist (18-25 pikë)
BNj 25 pikë	a: Prania joadekuatë ose e pamjaftueshme e burimeve njerëzore (BNj) për zbatimin e projektit (0-4 pikë)
	b: Prania e pjesshme e burimeve njerëzore me disa aftësi dhe kualifikime përkatëse (5-12 pikë)
	c: Ekipi i mjaftueshëm dhe i kualifikuar i burimeve njerëzore për zbatimin efektiv të projektit (13-20 pikë)
Kontributi (Kontributi në natyrë ose në para) 10 pikë	a: Asnjë kontribut në natyrë/para (0 pikë)
	b: Kontribut në natyrë/para deri në 10% (1-5 pikë)
	c: Kontribut i rëndësishëm në natyrë/para (6-10 pikë)
Lista e referencave të projekteve: 15 pikë	a: Një deri në dy referenca të projekteve (0-5 pikë)
	b: Tre deri në pesë referenca të projekteve (6-10 pikë)
	c: Mbi gjashtë referenca të projekteve (10-15 pikë)

12.Shpenzimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme në propozim mund të përfshijnë shpenzime direkte, të tilla si rrogat, pajisjet, furnizimet dhe shpenzimet e udhëtimit, si dhe shpenzime indirekte si qiraja, shërbimet publike (komunale) dhe shpenzimet administrative. Megjithatë, të **shuma e shpenzimeve indirekte të përfshira nuk mund të kalojë 7% të totalit të shpenzimeve direkte të pranueshme.**

Shpenzimet e pranueshme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të kenë ndodhur gjatë zbatimit të marrëveshjes së nën-grantit,
- të jenë shënuar në buxhet,
- të jenë të nevojshme dhe të korrespondojnë me aktivitetet e projektit,



Ndërtimi i një Mjedisi Ekonomik më të Gjellbër

- të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme, veçanërisht të jenë regjistruar në regjistrat kontabël të përfituesve të nën-granteve,
- të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe social në fuqi, dhe
- të jenë të arsyeshme dhe të justifikuara.

Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e mëposhtme nuk do të konsiderohen të pranueshme për financim:

- a) borxhet, si dhe tarifatat e shërbimit të borxhit (kamatat);
- b) provizionet për humbjet ose detyrimet e mundshme të ardhshme;
- c) artikujt e financuar tashmë nga një donator tjetër;

E rëndësishme: Çdo kosto që ka ndodhur përpara datës zyrtare të fillimit të marrëveshjes ose pas finalizimit të marrëveshjes konsiderohet si kosto e papranueshme dhe nuk do të financohet.

13.Kontraktimi

Nën-grantet do t'u jepen aplikantëve të suksesshëm bazuar në vlerësimin e propozimeve të tyre. CNVP-ja do të nënshkruajë një kontratë me aplikantët e suksesshëm, e cila do të përshkruajë termat dhe kushtet e nën-grantit.

14.Raportimi dhe Monitorimi

Nën-grantistëve do t'u kërkohet të paraqesin raporte të rregullta të progresit në CNVP. Gjithashtu do të kryhen vizita monitoruese për të siguruar që nën-grantistët janë duke i zbatuar aktivitetet ashtu siç janë propozuar.